



PRESS RELEASE

PËR SHPËRNDARJE TË MENJËHERSHME:

19 mars 2010

Për më shumë informacion:

Kontakti: Zj. Laureta Memo

Zyrë: +355-4-266-637

Cel: 0692033823

Email: Imemo@lgpa.al

<http://albania.usaid.gov>

www.lgpa.al

Hapet Zyra e Informacionit Turistik në Shkodër

19 MARS, 2010 Bashkia e Shkodrës hapi sot Zyrën e Informacionit Turistik në vijim të përpjekjeve të saj të vazhdueshme për promovimin e turizmit. Kjo zyrë do të ofrojë shërbime informacioni turistik profesional pa pagesë dhe të një cilësie të lartë për gjithë turistët dhe vizitorët.

Aktiviteti i sotëm u përshendet nga Kryetari i Bashkisë, z. Lorenc Luka, dhe përfaqësuesi i USAID z. Stephen Herbaly. Në fjalën e tyre ata theksuan rëndësinë e kësaj zyre për qytetin dhe bizneset e turizmit.

Programi i USAID për Qeverisjen Vendore (LGPA) dhe Bashkia e Shkodrës punojnë së bashku për nxitjen e zhvillimit të turizmit si gjenerues i punësimit dhe rritjes ekonomike në Shkodër. Kjo nismë është një Partneritet Publiko-Privat mes Bashkisë, LGPA, dhe kompanisë Çelësi. Zyra e Informacionit Turistik, e cila është ndërtuar nga Bashkia, do të vihet në funksionim nga kompania Çelësi. Bashkia do të punojë me Zyrën për promovimin e bizneseve turistike vendore. Zyra e Informacionit Turistik do të jetë shtysë për zhvillimin e këtij sektori të rëndësishëm për ekonominë e qytetit si dhe krijimin e investimeve private e nxitjen e zhvillimit ekonomik vendor.

“Bashkia e Shkodrës është shumë mbështetëse për zhvillimin e turizmit në qytet,” tha z.Luka. “Kjo zyrë do të jetë e pajisur me guida të ndryshme turistike dhe do të promovojë aktivitetet e shumta kulturore të qytetit, kaq të rëndësishme për zhvillimin ekonomik”. Shkodra organizon për vit mjaft aktivitete të suksesshme, të tilla si Festa e Karnavaleve, Panairi i Artizanëve, Dita e Luleve, Festivali i Muzikës Qytetare, etj., duke sjellë turistë e vizitorë nga mbarë Shqipëria.

Programi i Qeverisjes Vendore në Shqipëri (LGPA) i USAID punon me bashki partnere në të gjithë Shqipërinë për të mbështur zhvillimin e ekonomisë vendore, përmirësimin e qeverisjes dhe forcimin e pjesëmarrjes së shoqërisë civile dhe sektorit privat në zhvillimin vendor. Bashkitë partnere të LGPA janë Elbasani, Fieri, Fushë Kruja, Gramshi, Korça, Kukësi, Lezha, Librazhdi, Pogradeci, dhe Shkodra.

###